



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 7871

Tirane më 04/10/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



V2024053950480680670

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"GEN.ER. BUILDING SYSTEM" Shpk

Ne Tirane, sot me date 04 Tetor 2024, me cilesine e "ortakeve themelues".

GEN.ER. BUILDING SYSTEM SRL shoqëri italiane, me seli ne San Serevo (FG), Via Salvatore Tempesta 6 Cap 71016, me numer Regjistrimi 04180900716 perfaqesuar nga Ortaket e meposhtem:

Gentjan Deda, shtetas Italian, i biri i Pjeter dhe e Mri, lindur ne Thumane me 18/04/1977, ne adresen: Via Einaudi, 171016- San Severo (FG), madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr personal CA84282GG

Ermir Dedaj, shtetas Italian, i biri i Pjeter dhe e Mri, lindur ne Thumane me 17/09/1983, ne adresen: Via Cicerale, 771016- San Severo(FG), madhor e me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr personal CA26248OX,

me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bizneseve", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "GEN.ER.BUILDING SYSTEM" Shpk (me poshte e quajtur "Shoqeria")

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria "GEN.ER.BUILDING SYSTEM" Shpk,eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "GEN.ER.BUILDING SYSTEM" Shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaket", te cilet pergjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne humbjet e shoqërisë deri në pjesën e kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.


Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen: " Rruga Andon Zako Cajupi, hyrja nr.2, ap.3, Tirane ne ZK 8270, me nr. Pasurie 2/234+2-3", Tiranë, Shqipëri".

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve.

Dedaj Ermir

Gentjan Deda



Neni 4
Objekti i veprimtarise

Veprimtarine e prodhimit te produkteve metalike, te qyngjeve, te shiut dhe produkteve te tjere me pergjithesi, ne seri ose sipas dizenjimit, ne teneqe zingu, alumini, bakri, celiku te lehte dhe/ose materiale te tjera, ndertimin e mbulesave te cative te ndertesave dhe te strukturave te tyre dhe mbajteseve te tyre, dhe te parafabrikuara, ne seri apo sipas dizenjimit, ne dru, celik, hekur ose materiale te tjera, vendosja e tyre ne pune; Ndertimi dhe perpunimi ne sektorin e teneqes industriale dhe mekanike dhe tregtimin e prodhimit; teneqeri, civile dhe industriale, perkulje teneqe me prese dhe vendosja ne pune me ndezje, shirash dhe qyngjesh dhe per llogari te te treteve; - Heqja dhe venia ne pune e cative dhe mbulesave te tyre, fikse dhe te vetratave, si ne metal dhe ne dru, edhe te parafabrikuara si dhe te strukturave te tyre, mirembajtjen e tyre edhe per llogari te te treteve; - Ndertimin, shembjen, ristrukturimin, restaurimin dhe mirembajtjen e ndertesave civile, industriale dhe tregtare, private apo publike, te impianteve sportive te cdo tipi dhe natyre; - Tregtimin, me shumice dhe pakice, edhe permes internetit, te materialeve te ndertimit dhe te materialeve te drurit dhe/ose hekurit ne pergjithesi, te perpunuar ose jo. Objekti i veprimtarise mund te permbushet dhe permes pjesemarrjes ne konkurse, gara, ankande, tendera dhe nenkontrata publike te shpallura nga shteti, privat, ente apo slaoqeri. Shoqeria ne menyre jo mbizoteruese pro ne funksionin instrumental te permbushjes se objektit te veprimtarise te pershkruar me siper dhe per pasoje ne rmenyre vetem okazionale, mundet gjithashtu te kryeje operacione tregtare, industrial dhe imobiliare dhe gjithashtu —me perjashtim te cdo operacioni te kryer “nga dhe ndaj publikut“ mund te kryeje operacione financiare dhe mobiliare qe organi i saj administrativ do i vleresoje te nevojshme apo te dobishine me qellim qe te mundesoje ushtrimin e veprimtarise sipas objektit te veprimtarise te pershkruar me larte. Shoqeria brenda kufijve te renditura me siper dhe ne funksion te permbushjes se objektit primar te veprimtarise, mundet, ne vecanti te kryeje: operacione financimi passive, edhe permes nenshkrimet te kontratave te kredise me dhenien e garancive reale mbi pasuri te paluajtshme ne pronesi te shoqerise; operacione per celjen e marredhenieve bankare ne llogari rrjedhese; operacione qe kane per objekt leshimin e dorezanive me limite maksimale te paracaktuara; te garancive ne pergjithesi, edhe reale, ne favor te kujtdo, si ne interes te shoqerise ashtu dhe per te trete; operacione te marrjes, me qellim investimin e qendrueshem dhe jo per qellim transferimin prane publikut, direkt apo indirekt, te pjesmarrjeve dhe/ose kuptave te pjesmarrjes, ne shoqeri te tjera, italiane apo te huaja, te themeluara apo qe do te themelohen, qe kane qellime te ngjashme ose analoge me te saj, gjithmone nese, per masen dhe objektin e pjesmarrjes, nuk reziilton — ne fakt — i ndryshuar objekti i veprimtarise i pershkruar me si per.

Neni 5
Kohezgatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000,00 leke.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga “ortaket”i shoqerise:

Dedo; E. ...

G. ...

GEN.ER. BUILDING SYSTEM SRL-me seli ne San Serevo (FG) Via Salvatore Tempesta 6 Cap 71016, me numer Regjistrimi 04180900716 - zoteron 100% te kapitalit me vleren 10 000 leke (dhjete mije).

Kontributi i ortaket mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund të zvogëlohet me vendim tunanim të Ortakeve te Shqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Bizneseve për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bizneseve".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim perpara nje noteri.

Ne rastin e shitjes se kuotave nga njeri ortak, ortaku tjetër gezon te drejten e parablerjes se tyre.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimarrës


Ortaket perbejne organin e vetem vendimarrës te shoqerise (Asamblene e Pergjithshme), qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendosin për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë ;

Dedvi Brunar

Gejran Berbo

- 
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve ;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Neni 10

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, ose sa here që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit “ Per shoqërite Tregtare”.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 11

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Neni 12

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Debi, Ermon

Gejran Beda

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm..

Neni 13
Kuorumi

1. Vendimet ne Asamblese merren nese te pranishem jane te gjithë ortaket.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet te votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 14
Administrimi

Administrator i shoqërisë është Gentjan Deda, shtetas Italian, i biri i Pjeter dhe e Mri, lindur ne Thumane me 18/04/1977, ne adresen: Via Einaudi, 171016- San Severo (FG), madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr personal CA84282GG.

Administratori i shoqërisë do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vit me te drejte ripërteritje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim unanim te Ortakeve te shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 15
Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare ;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen Asamblese se Pergjithshme edhe ne rastet kur :

Aedo, Emer.

Gejtr Peolo

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 16 Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara unanimisht nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) i kthen ortakut kontributet;
 - b) i paguan ortakut interesa apo dividendë;

Ado, Emir

Garip Bebo

- c) i shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 17
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Bizneseve dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 18
Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Pergjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Asambleja e Pergjithshme vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Kontabiliteti mbahet ne gjuhen Shqipe dhe monedhen Shqiptare si dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkates. Per operatione te vecanta, Shoqeria mund te beje veprime edhe per llogari te vecanta ne monedhe te huaj, duke bere konvertimin brenda vitit.

Shoqeria mund te pranoje fonde nga institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte. Per kete qellim shoqeria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci.

Neni 19
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 20
Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "GEN.ER.BUILDING SYSTEM" shpk, u redaktua nga "Ortaket Themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKET
"GEN.ER.BUILDING SYSTEM" Shpk

Gentjan Deda

Ermir Dedaj

GEN.ER. BUILDING SYSTEM SRL
Gentjan Deda
Gentjan Deda

GEN.ER. BUILDING SYSTEM SRL
Via Tompeste, 6 - 71016 San Severo (Fg)
P.IVA e Cod. Fisc.: 04180900716
info@genersystem.it - Cod. Univoco: SUBNTON

ERMIR DEDAJ
Dedaj, Ermir

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU



DATE 04/10/2024
NR REP 7871

"Taksa e P...

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04.10.2024, para meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

DEKLARUESIT:

Gentjan Deda, atësia Pjeter, amësia Mri, shtetas Italian, lindur në Thumane dhe banues në adresë Via Einaudi, 171016-San Severo (Fg), Itali, lindur më 18/04/1977, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim me nr. CA84282GG;

Ermir Dedaj, atësia Pjeter, amësia Mri, shtetas Italian, lindur në Thumane dhe banues në Thumane, me adresë Itali, lindur më 17/09/1983, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID me Nr. CA26248OX;

te cilet, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, dokumentin bashkëlidhur Akt Themelimi i shoqërisë në krijim e sipër "GEN.ER.BUILDING SYSTEM" Shpk.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU